



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**Raport Përfundimtar për Auditimin Tematik të ushtruar në
“Bashkinë Durrës”**

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN TEMETIK

“BASHKIA DURËS”

**(Auditim Financiar, mbi pasqyrat
financiare 2020)**

Tiranë, 2021

PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITULJE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4 - 7
I.2	Konkluzioni dhe Opinioni Auditimit	7 - 8
II	HYRJA	8 - 13
	a. Titulli. b. Marrësi. c. Objektivat dhe qëllimi. d. Identifikimi i çështjes. e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. f. Përgjegjësitë e Audituesve. g. Kriteret e vlerësimit. h. Standardet e auditimit. i. Metodatat e auditimit. j. Dokumenti i auditimit.	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13 -
III.1.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	13 - 20
	<i>A-Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.</i>	
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI	20 - 22
VI.	ANEKSET	22 - 35

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, monitorimi i tyre nga Auditimi i Brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Durrës.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga SIFQ¹, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, si më poshtë:

Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”; Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”; Llogaritë 230 dhe 231 “Investime...”; Llogaritë 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, “Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive”; Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”; Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”; Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione”; Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”; Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”; Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune”; Llogaria 215 “Mjete transporti”; Llogaria 218 “Inventar ekonomik”; Llogaritë e Klasës 25/26 “Aktivet Afatgjata Financiare”; Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”; Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”; Llogaria 4342 “Operacione me shtetin”; Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”; Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”; Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”; Llogaria 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”; Llogaria “435 “Sigurime Shoqërore”; Llogaria “436 “Sigurimet shëndetësore”; llogaritja dhe paraqitja e amortizimit, etj.

600 “Paga”, 602 “Shpenzime operative” dhe 230-231 “Investime”.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (balance) të viti 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një “Opinion i modifikuar”, pasi disa nga llogaritë nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancës financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referencat në Raport	Rekomandimi
1.	Nga auditimi i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime”, rezultoi se: Gjatë vitit ushtrimor 2020, janë nxjerrë jashtë përdorimi 4 studime dhe kërkime, pasi nga sektori i financës është arsyetuar se studim-kërkimet kanë mbaruar funksionin si dhe qëllimin për të cilën janë hartuar dhe për rrjedhojë janë shkarkuar nga kontabiliteti. Nga	E mesme	13-20	Nga ana e Nëpunësit Autorizues të Bashkisë Durrës të ngrihet një komision vlerësimi, i cili mbi bazën e të dhënave kontabël, vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerësimin e kosto-përfitimit, të hartojë një proces vlerësimi mbi aktivet afatgjata jo materiale ku të hartohet edhe lista e nxjerrjes jashtë përdorimi të

¹ Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	analitiku i llogarisë u konstatua se pjesa më e madhe e studimeve dhe kërkimeve i përkasin një periudhe kohore të hershme më shumë se 3 vite, si dhe nuk është kryer rivlerësimi i këtyre projekteve nëpërmjet një komisioni vlerësimi.			këtyre aktiveve nëpërmjet relacioneve shpjeguese. Nga Sektori i Financës së Bashkisë Durrës, bazuar në relacionet e kryera nga komisioni i vlerësimit, të bëhen rregullimet e duhura në kontabilitet, shkarkimet nga kontabiliteti nëse ka si dhe rivlerësimin e aktiveve afatgjata jo materiale
2.	Në Bashkinë Durrës, në vitin 2020 për llogaritë, 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. -Për periudhën ushtrimore 2020 mungojnë relacionet për rezultatet e inventarëve nga krahasimi i gjendjes kontabël me gjendjen fizike si dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve. -Amortizimi i llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale është kryer në grup aktivesh sipas llojit dhe jo për çdo aktiv në mënyrë të veçantë.	E larte	13-20	Nga Bashkia Durrës, të merren masa nga Sektori i Pronës Publike dhe Nëpunësi Zbatues nga ku të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
3.	Nga analizimi i kontratave për investime publike për vitet 2018 dhe 2019 kemi përpunuar të dhënat, gjendjen e detyrimeve të prapambetura nga shpenzimet kapitale. Nga përpunimi i të dhënave kemi realizuar testimin e saktësisë së llogarisë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” si llogari debitorë dhe testimin e saktësisë së llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” si	E larte	13-20	Nga Sektori i Financës të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për shumën 66,589,586 lekë për kontratat e lidhura gjatë viteve 2018-2019, ku rezultojnë të pa likuiduara. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësi a	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	llogari kreditore të regjistrimit në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, vendimeve gjyqësore për shkak të mungesës së fondeve. <u>Detyrimet nga kontratat për investime publike gjatë viteve 2018-2019:</u> Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, që kanë lidhje me 9 kontrata, ku vlera e mbetur e palikujduara e tyre prej 66,589,586 lekë nuk është evidentuar në kontabilitet. Vlerë kjo e cila duhej të përfshihej në pasqyrat financiare të vitit 2020 në llogarinë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me kundërparti llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, duke qenë se janë kontrata të cilat ju ka kaluar afati 2 vjeçar, si dhe likuidimi i tyre duhej të parashikohej edhe në PBA 2018-2021. Pra shihet qartë se detyrimi i prapambetur lindur nga shpenzimet kapitale në vitet 2018 dhe 2019, nuk është pasqyruar. Kjo ka sjellë mos pasqyrimin e saktë të gjendjes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën 66,589,586 lekë, për vitin financiar të mbyllur 2020. (Aneksi nr.3.1)			
4.	Nga auditimi i kontratave për investime publike dhe për mbikëqyrje punimesh për vitin 2020 rezultoi se disa fatura nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2020 si një detyrim për tu paguar: <u>1.Për kontratën e lidhur me OE A...,</u> në datën 12.10.2020 për investimin	E larte	13-20	Nga Bashkia Durrës, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, duke e nënvlerësuar me 31,365,269 lekë, si rrjedhojë e mos regjistrimit të faturave të cilat i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fiskal 2020. Nga ana e Bashkisë Durrës, pas saktësimit të detyrimeve të

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	“Loti nr.2, Rikonstrukcion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa pallat në kuadër të procesit të rindërtimit”, me vlerë kontrate me TVSh 134,561,020 lekë, me financim nga Buxheti i Shtetit, me urdhër shpenzimin nr.153 datë 10.02.2021 është likuiduar vlere e faturës prej 30,344,910 lekë, (fatura nr.54 datë 30.12.2020), kjo faturë duhej të paraqitej në pasqyrat financiare të vitit 2020, në llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, si një detyrim për t’u paguar pasi i përket vitit ushtrimor 2020. <u>2.Për kontratën e lidhur me OE T...</u>, në datën 22.10.2020 për mbikëqyrjen e punimeve “Loti nr.2, Rikonstrukcion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa pallat në kuadër të procesit të rindërtimit”, me vlerë kontrate me TVSh 1,379,350 lekë, me financim nga Buxheti i Shtetit, me urdhër shpenzimet nr.414 datë 11.03.2021 dhe nr.416 datë 11.03.2021 janë likuiduar vlerat e faturave prej 717,262 lekë dhe 303,457 lekë, (fatura nr.45 datë 21.12.2020 dhe fatura nr.03 datë 30.12.2020), fatura të cilat duhet të paraqiteshin në pasqyrat financiare të vitit 2020, në llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, si një detyrim për t’u paguar pasi i përket vitit ushtrimor 2020. Detyrimet në total prej 31,365,629 lekë, duhet të ishin pasqyruar në analitikët e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, pasi janë detyrime të konstatuara gjatë vitit ushtrimor 2020 referuar dhe datave të faturave përkatëse. Mos kryerja e veprimeve kontabël për këto detyrime e si			prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësi a	Referenc a në Raport	Rekomandimi
	rrjedhojë mospërfshirjen e vlerës që lindin nga këto detyrime ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale në fund të vitit ushtrimor 2020, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real për detyrimet që ka Bashkia ndaj të tretëve. (Aneksi nr.3.2).			
5	Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Durrës, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 178,266,156 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5% Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se përbëhet nga 186 objekte nga të cilat për 125 objekte në vlerën prej 84,474,102 lekë, janë fonde që gjenden të ngurtësuara deri në vitin 2018, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhbllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Drejtoria e Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës. Pra llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 84,474,102 lekë për vitin 2020 .	E larte	13-20	Nga Bashkia Durrës, Sektori i Financës dhe Sektori i mbikëqyrjes së kontratave, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duke rakorduar sektorët çdo muaj mbi gjendjen e llogarisë nr.466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tanimë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Durrës (Aparati), për vitin ushtrimor 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar:

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Durrës, duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërfutshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020.

Baza për opinionin i modifikuar:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Durrës, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa.

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Bashkia Durrës, sa i takon llogarive të mëposhtme:

- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, është mbivlerësuar për 84,474,102 lekë për vitin 2020
- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, është nënvlerësuar me 31,365,629 lekë për vitin 2020.
- Mangësi në regjistrat e aktiveve afatgjata materiale si dhe sistemi i vlerës aktuale të llogarisë nr.202 “Studime dhe Kërkime”.
- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është pasqyruar më pak në vlerën 66,589,586 lekë, vlerë e mbetur nga kontratat e lidhura gjata viteve 2018 dhe 2019, të cilave ju ka kaluar afati 2-vjeçar.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Durrës.

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Durrës, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Objekivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të kolauduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me

standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

II/1. PËRSHKRIM I AUDITIMIT.

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 678, datë 14.6.2021 dhe autorizimit nr. 678/4, datë 14.6.2021 “Mbi auditimin e pasqyrave financiare viti 2020”, të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 14.6.2021 – 2.7.2021, në subjektin Bashkia Durrës për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 – 31.12.2020, u krye auditimi “Auditim Financiar mbi pasqyrat financiare viti 2020”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K.GJ.,** *Përgjegjës Grupi*
2. **E.C.,** *Auditues*
3. **A.H.,** *Auditues*

a- Titulli: Auditim financiar në Bashkinë Durrës.

b- Marrësi: Raporti i Auditimit Tematik i drejtohet subjekti të audituar Bashkinë Durrës.

c- Objektivat dhe qëllimi: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

d- Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej

subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësive vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Durrës, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit të gjyqimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Durrës.

e- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Administratori i Përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) E.S. me funksion Kryetar i Bashkisë Durrës dhe Drejtore e Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ) H.H., janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Durrës, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34, pika 6², neni 65, pika 1³ dhe neni 91, pika 1.3⁴.

f- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Durrës dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- *Etika dhe pavarësia;*
- *Kontrolli i cilësisë*
- *Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësi të tyre*

² “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”

³ “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

⁴ “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
- b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
- ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit”.

- *Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

- *Përkatesia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
- *Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
- *Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
- *Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës.

- *Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë
- *Të drejtat dhe detyrimet:* Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
- *Plotësia:* Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Vlerësimi dhe alokimi:* Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese.

- *Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:* Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
- *Klasifikimi dhe kuptueshmëria:* Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
- *Saktësia dhe vlerësimi:* Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

g- Kriteret e vlerësimit: Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

- **Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare:**
Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”, aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësjive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësjive të Qeverisjes së Përgjithshme”; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

h- Standardet e auditimit: ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

i- Metodat e auditimit: Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin⁵.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- **Kontrolli aritmetik.** Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.** Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.** Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- **Kontrolli i vlerësimit.** Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

⁵ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërive ose të çdo regjistrimi tjetër.
- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
- ***Intervista***
- ***Raporte dhe Informacione***
- ***Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK***

j- Dokumentimi i auditimit: Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja⁶.

Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në kundërshtitë, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

III/1. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimit të auditimit.

⁶ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

1. Titulli gjetjes: *Mbi mos hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduar të vitit 2020*

Situata:

Bashkia Durrës për vitin 2020 nuk ka hartuar Pasqyra Financiare të konsoliduar ku të paraqiten informacioni kontabël i konsoliduar me qëllim besueshmërinë e llogarive të konsoliduar mbi aktivet, detyrimet, aktivet neto / fondet neto si dhe të ardhurat, shpenzimet, fluksin e mjeteve monetare

Kriteri:

Ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu IV ku citohet: “Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar.”, nenet nr.98, 99, 100, 101, 102, 103 dhe pika nr.4.1 të këtij Kreu

Ndikimi/Efekti:

Mungesë informacioni kontabël mbi llogaritë e konsoliduar për vitin 2020

Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël mbi përgatitjen dhe hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduar

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi:

Drejtori Ekonomik, në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të merren masa për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduar, si dhe të ndiqen rregullat kontabël të parashikuara për hartimin e informacionit kontabël të konsoliduar ku të përfshihen pasqyrat financiare të aparatit dhe të njësive varëse.

2. Titulli i gjetjes: *Mbi rivlerësimin e Aktiveve Aftatgjata Jomateriale, si dhe procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi*

Situata:

Nga auditimi i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime”, rezultoi se: Gjatë vitit ushtrimor 2020, janë nxjerrë jashtë përdorimi 4 studime dhe kërkime, pasi nga sektori i financës është arsyetuar se studim-kërkimet kanë mbaruar funksionin si dhe qëllimin për të cilën janë hartuar dhe për rrjedhojë janë shkarkuar nga kontabiliteti. Nga analitiku i llogarisë u konstatua se pjesa më e madhe e studimeve dhe kërkimeve i përkasin një periudhe kohore të hershme më shumë se 3 vite, si dhe nuk është kryer rivlerësimi i këtyre projekteve nëpërmjet një komisioni vlerësimi

Kriteri:

Ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare

vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” . Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 34, 35, 95, 96 dhe pika 111

Ndikimi/Efekti:

Nxjerrja jashtë përdorimi e kryer pa një proces vlerësimi të kësaj llogarie, si dhe mungesa e rivlerësimit të studimeve dhe kërkimeve

Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël mbi vlerësimin e aktiveve të njësisë

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi:

Drejtori Ekonomik, në cilësinë e Nënpunësit Zbatues të Bashkisë Durrës, të ngrihet një komision vlerësimi, i cili mbi bazën e të dhënave kontabël, vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerësimin e kosto-përfitimit, të hartojë një proces vlerësimi mbi aktivet afatgjata jo materiale ku të hartohet edhe lista e nxjerrjes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve nëpërmjet relacioneve shpjeguese.

Bazuar në relacionet e kryera nga komisioni i vlerësimit, të bëhen rregullimet e duhura në kontabilitet, shkarkimet nga kontabiliteti nëse ka si dhe rivlerësimin e aktiveve afatgjata jo materiale.

3. Titulli i gjetjes: *Mungesa e një regjistri kontabël për Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jo Materiale, si dhe mangësi në inventarizimin e tyre*

Situata:

Në Bashkinë Durrës, në vitin 2020 për llogaritë, 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

-Për periudhën ushtrimore 2020 mungojnë relacionet për rezultatet e inventarëve nga krahasimi i gjendjes kontabël me gjendjen fizike si dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve.

-Amortizimi i llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale është kryer në grup aktivesh sipas llojit dhe jo për çdo aktiv në mënyrë të veçantë.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata, e cila paraqet parregullsi janë Ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat nga 10,12,81,83,85,86 26-30, 74, 96-101, 102 dhe 103.

Ndikimi/Efekti:

Nga mungesa e informacionit në mënyrë analitike për secilin aktiv si dhe mungesa e një regjistri kontabël për çdo llogari të aktiveve sjell një pasqyrim jo të saktë të këtyre vlerave kontabël.

Shkaku:

Mosnjohje e moszbatimit i udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi:

Nga Bashkia Durrës, të merren masa nga Sektori i Pronës Publike dhe Nënpunësi Zbatues nga ku të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin

aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

4. Titulli gjetjes: *Mbi kontabilizimin e shpenzimeve të periudhave të ardhshme, njohjes së detyrimeve për kontratat për investimet publike, të kryera në vitet 2018 dhe 2019.*

Llogaria nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, për vitin ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 185,428,873 lekë me kundërparti llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm, vlera që përfaqësojnë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera dhe të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve si dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.

Detyrimet e prapambetura nga shpenzimet për investimet vihet re fenomeni i krijimit të këtyre detyrimeve pothuajse në të gjitha rastet mbi një periudhë më të hershme mbi 3 vjet nga viti 2020. Nga ana e Sektorit të Financës na është dhënë shpjegim që këto detyrime kaq të hershme kanë ardhur si rrjedhojë e keqmenaxhimit të Ish-Komunave (pasi kanë qenë shpenzime të kryera nga këto njësi), para futjes në fuqi të reformës administrative-territoriale. Për rrjedhojë këto detyrime të cilat i përkasin Ish-Komunave, përbëjnë një rëndesë në buxhetin e Bashkisë Durrës, dhe nuk janë likuiduar gjatë periudhës ushtrimore 2020.

Për vitet 2018-2019 janë lidhur 66 kontrata në vlerën 1,475,135,724 lekë për investimet e kryera, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Ministrisë linjës dhe FZHR. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa, Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, që kanë lidhje **me 9 kontrata, ku vlera e mbetur e palikujduara e tyre prej 66,589,586 lekë nuk është evidentuar në kontabilitet.** Vlerë kjo e cila duhej të përfshihej në pasqyrat financiare të vitit 2020 në llogarinë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me kundërparti llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, duke qenë se janë kontrata të cilat ju ka kaluar afati 2 vjeçar, si dhe likuidimi i tyre duhej të parashikohej edhe në PBA 2018-2021 dhe PBA 2019-2021

Situata:

Nga analizimi i kontratave për investime publike për vitet 2018 dhe 2019 kemi përpunuar të dhënat, gjendjen e detyrimeve të prapambetura nga shpenzimet kapitale. Nga përpunimi i të dhënave kemi realizuar testimin e saktësisë së llogarisë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” si llogari debitorë dhe testimin e saktësisë së llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” si llogari kreditorë të regjistrimit në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, vendimeve gjyqësore për shkak të mungesës së fondeve.

Detyrimet nga kontratat për investime publike gjatë viteve 2018-2019:

Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, që kanë lidhje me **9 kontrata**, ku vlera e mbetur e palikujduara e tyre prej 66,589,586 lekë nuk është evidentuar në kontabilitet. Vlerë kjo e cila duhej të përfshihej në pasqyrat financiare të vitit 2020 në llogarinë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me kundërparti llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, duke qenë se janë kontrata të cilat ju ka kaluar afati 2 vjeçar, si dhe likuidimi i tyre duhej të parashikohej edhe në PBA 2018-2021.

Pra shihet qartë se detyrimi i prapambetur lindur nga shpenzimet kapitale në vitet 2018 dhe 2019, nuk është pasqyruar. Kjo ka sjellë mos pasqyrimin e saktë të gjendjes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën **66,589,586 lekë**, për vitin financiar të mbyllur 2020.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32, 42.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të shpenzimeve të periudhave të ardhshme në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6, neni 10 dhe 11; të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i shfuqizuar, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi:

Nga Sektori i Financës të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për shumën **66,589,586 lekë** për kontratat e lidhura gjatë viteve 2018-2019, ku rezultojnë të pa likuiduara. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021 (sipas Tabelës aneks nr.3.1;).

5. Titulli gjendjes: Mbi kontabilizimin e shpenzimeve të periudhave të ardhshme, njohjes së detyrimeve për kontratat për investimet publike dhe mbikëqyrje punimesh, të lidhura gjatë vitit 2020 dhe mos regjistrimi i disa faturave në llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Situata:

Nga auditimi i kontratave për investime publike dhe për mbikëqyrje punimesh për vitin 2020 rezultoi se disa fatura nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2020 si një detyrim për tu paguar:

1.Për kontratën e lidhur me OE A..., në datën 12.10.2020 për investimin “Loti nr.2, Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa pallat në kuadër të procesit të rindërtimit”, me vlerë kontrate me TVSh 134,561,020 lekë, me financim nga Buxheti i

Shtetit, me urdhër shpenzimin nr.153 datë 10.02.2021 është likuiduar vlera e faturës prej **30,344,910 lekë**, (fatura nr.54 datë 30.12.2020), kjo faturë duhej të paraqitej në pasqyrat financiare të vitit 2020, në llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, si një detyrim për t’u paguar pasi i përket vitit ushtrimor 2020.

2.Për kontratën e lidhur me OE T..., në datën 22.10.2020 për mbikëqyrjen e punimeve “Loti nr.2, Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa pallat në kuadër të procesit të rindërtimit”, me vlerë kontrate me TVSh 1,379,350 lekë, me financim nga Buxheti i Shtetit, me urdhër shpenzimet nr.414 datë 11.03.2021 dhe nr.416 datë 11.03.2021 janë likuiduar vlerat e faturave prej **717,262 lekë** dhe **303,457 lekë**, (fatura nr.45 datë 21.12.2020 dhe fatura nr.03 datë 30.12.2020), fatura të cilat duhet të paraqiteshin në pasqyrat financiare të vitit 2020, në llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, si një detyrim për t’u paguar pasi i përket vitit ushtrimor 2020.

Detyrimet në total prej **31,365,629 lekë**, duhet të ishin pasqyruar në analitikët e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, pasi janë detyrime të konstatuara gjatë vitit ushtrimor 2020 referuar dhe datave të faturave përkatëse. Mos kryerja e veprimeve kontabël për këto detyrime e si rrjedhojë mospërfshirja e vlerës që lindin nga këto detyrime ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale në fund të vitit ushtrimor 2020, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real për detyrimet që ka Bashkia ndaj të tretëve.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32, 42.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të shpenzimeve të periudhave të ardhshme në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare si dhe mos regjistrimi i faturave të cilat janë likuiduar në vitin 2021 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fiskal që mbyllet më 31.12.2020

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6, neni 10 dhe 11; të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i shfuqizuar, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi:

Drejtori Ekonomik, në cilësinë e Nënpunësit Zbatues të Bashkisë Durrës, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, duke e nënvlerësuar me 31,365,269 lekë, si rrjedhojë e mos regjistrimit të faturave të cilat i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fiskal 2020.

Pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave. (sipas Tabelës aneks nr.3.2;).

6. Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”

Situata:

Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Durrës, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 178,266,156 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se përbëhet nga 186 objekte nga të cilat për **125 objekte** në vlerën prej **84,474,102 lekë**, janë fonde që gjenden të ngurtësuara deri në vitin 2018, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhbllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Drejtoria e Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Pra llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është mbivlerësuar për 84,474,102 lekë për vitin 2020.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10” ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Nga Bashkia Durrës, Sektori i Financës dhe Sektori i mbikëqyrjes së kontratave, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duke rakorduar sektorët çdo muaj mbi gjendjen e llogarisë nr.466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tanimë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Pretendimi i subjektit të audituar.

1. Përsa i takon pjesës për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduar, deri në momentin e kontrollit nuk ishin sjellë bilancet nga të gjitha Institucionet e varësisë pranë zyrës së financës në Bashki.
2. Përsa i takon analizës së kontratave për investimet e viteve 2018-2019 si dhe detyrimeve që rrjedhin nga likuidimi i tyre, kontratat e vitit 2018 janë likuiduar të gjitha, bashkëngjitur pasqyra me datat e pagesave. Kontratat e vitit 2019 për shkak të problemeve të shkaktuara nga tërmeti disa prej tyre nuk janë mbyllur. Bashkëngjitur pasqyra me shlyerjet.

Sa i takon faturave për këto objekte, ju bëjmë me dije se për këto kontrata të pa mbyllura akoma nuk kemi as situacion as dhe fatura për punimet e kryera. Këto kontrata janë futur në buxhetin e vitit 2021 dhe janë miratuar në KB me vendim nr.21 datë 25.02.2021 Për sa shpreheni lidhur me njohjen e shpenzimit, ju bëjmë me dije se pa dokumentet që vërtetojnë kryerjen e shpenzimit situacion dhe faturë përkatëse nuk kemi si e njohim shpenzimin.

3. Përsa i takon studimeve që janë hequr nga përdorimi ju sqaroj se lidhur me këto studime ka mbaruar funksioni dhe qëllimi pasi me vendim nr.1 datë 16.01.2020 të komitetit për menaxhimin e integruar të mbetjeve është vendosur mbyllja e vend depozitimit të mbetjeve në zonën e Porto Romanos.

4. Përsa i përket llogarisë nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione” mungesa e regjistrit të tyre nuk është përgjegjësi e zyrës së financës.

5. Përsa i takon llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, ju bëjmë me dije se zhbllokimi bëhet pasi në zyrën e financës paraqitet nga subjekti kërkesa për zhbllokim, e shoqëruar me aktin e marrjes në dorëzim dhe certifikatën e garancisë të lëshuar nga titullari pa këto dokumente zyra e financës nuk ka asnjë alternativë tjetër për zhbllokim.

6. Përsa i takon detyrimit 31,365,629 lekë që duhet të ishin pasqyruar në llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” ju sqarojmë se këto fatura bashkë me situacionet përkatëse janë paraqitur tek ne ditën në të cilën janë paguar, dhe në datën 20.01.2021 në të cilën është rakorduar me degën e thesarit dhe ky rakordim është dërguar në ministrinë e financave për këtë arsye nuk mund të shtoheshin në këtë llogari në bilancin e vitit 2020.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit

1. Nga ana e sektorit të financës, duhet të ishin hartuar pasqyrat financiare të konsoliduar sipas legjislacionit, për të dhënë një pasqyrë përmbledhëse për informacionin kontabël mbi aktivet, detyrimet, aktivet neto/ fondet neto, si dhe të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare. Për rrjedhojë pretendimin juaj se nuk janë sjellë të gjitha bilancet nuk qëndron dhe është në shkelje të afateve.

2. Në lidhje me sqarimin tuaj mbi shlyerjen e kontratave për investimet e vitit 2018 si dhe detyrimet që rrjedhin nga likuidimi i tyre, merret në konsideratë, nisur nga urdhër shpenzimet e kryera dhe të evidentuara te pasqyrat e dërguara në observacion.

Përsa i përket pretendimit tuaj se për kontratat e vitit 2019 të cilat rezultojnë të pa shlyera si pasojë e tërmetit dhe se sa i takon faturave për këto objekte dhe situacioneve për punimet e kryera nuk janë paraqitur si dhe këto kontrata janë përfshirë në buxhetin e vitit 2021, për rrjedhojë pjesa e pa likuiduar e këtyre kontratave duhej të regjistrohej në llogarinë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, duke qenë se janë kontrata të cilat ju ka kaluar afati 2 vjeçar, si dhe likuidimi i tyre ka qenë i parashikuar në programet buxhetore afatmesme 2018-2021 dhe 2019-2022. Pretendimi juaj merret pjesërisht në konsideratë. Reflektuar dhe në Raportin e Auditimit.

3. Në lidhje me sqarimin tuaj përsa i takon studimeve që janë hequr nga përdorimi si dhe funksioni dhe qëllimi i tyre kishte përfunduar bazuar dhe në vendimi nr.1 datë 16.01.2020 të dërguar nga ana juaj, merret pjesërisht në konsideratë përsa i përket qëllimit pse janë shkarkuar nga kontabiliteti por nga ana procedurale rezulton me mangësi pasi një procedurë e tillë kryhet nga komisioni i vlerësimit të aktiveve në zbatim të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

4. Përsa i përket llogarisë nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione” si dhe mungesa e regjistrit të tyre nuk është përgjegjësi e zyrës së financës, për këtë motiv pretendimi juaj merret në konsideratë, dhe për rrjedhojë në PRA është reflektuar përgjegjësia te zyra e Pronës Publike në Bashkinë Durrës për mangësitë e konstatuara dhe mungesa e një regjistri.

5. Përsa i takon llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” se zhbllokimi i tyre kryhet pasi në zyrën e financës paraqitet nga subjekti kërkesa për zhbllokim si dhe pa certifikatën e

garancisë të lëshuar nga titullari nuk mund të bëhet zhbllokimi i tyre, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë pasi duhen njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

6. Në lidhje me detyrimet nga faturat në vlerën 31,365,629 lekë, që duhet të ishin të pasqyruara në llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, pretendimi juaj se këto fatura bashkë me situacionet përkatëse janë paraqitur në ditën në të cilën janë paguar, nuk merret në konsideratë, pasi zyra e financës për faturat dhe situacionet përkatëse të cilat kanë datë më të hershme nga data në të cilën janë paguar duhej ti llogaritej penalitete sipas kushteve dhe detyrimeve kontraktuale për mos dorëzim në afat të situacioneve të punimeve dhe më pas të likuidoheshin.

IV/3.2. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Durrës për vitin 2020 nuk ka hartuar Pasqyra Financiare të konsoliduar ku të paraqiten informacioni kontabël i konsoliduar me qëllim besueshmërinë e llogarive të konsoliduar mbi aktivet, detyrimet, aktivet neto / fondet neto si dhe të ardhurat, shpenzimet, fluksin e mjeteve monetare.

1.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Financës së Bashkisë Durrës të përgatiten pasqyrat financiare të konsoliduar si dhe të ndiqen rregullat kontabël të parashikuara për hartimin e informacionit kontabël të konsoliduar ku të përfshihen pasqyrat financiare të aparatit dhe të njësive varëse.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime”, rezultoi se: Gjatë vitit ushtrimor 2020, janë nxjerrë jashtë përdorimi 4 studime dhe kërkime, pasi nga sektori i financës është arsyetuar se studim-kërkimet kanë mbaruar funksionin si dhe qëllimin për të cilën janë hartuar dhe për rrjedhojë janë shkarkuar nga kontabiliteti. Nga analitiku i llogarisë u konstatua se pjesa më e madhe e studimeve dhe kërkimeve i përkasin një periudhe kohore të hershme më shumë se 3 vite, si dhe nuk është kryer rivlerësimi i këtyre projekteve nëpërmjet një komisioni vlerësimi.

2.1. Rekomandimi: Nga ana e Nëpunësit Autorizues të Bashkisë Durrës të ngrihet një komision vlerësimi, i cili mbi bazën e të dhënave kontabël, vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerësimin e kosto-përfitimit, të hartojë një proces vlerësimi mbi aktivet afatgjata jo materiale ku të hartohet edhe lista e nxjerrjes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve nëpërmjet relacioneve shpjeguese.

Nga Sektori i Financës së Bashkisë Durrës, bazuar në relacionet e kryera nga komisioni i vlerësimit, të bëhen rregullimet e duhura në kontabilitet, shkarkimet nga kontabiliteti nëse ka si dhe rivlerësimin e aktiveve afatgjata jo materiale.

Brenda vitit ushtrimor

3. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Durrës, në vitin 2020 për llogaritë, 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

-Për periudhën ushtrimore 2020 mungojnë relacionet për rezultatet e inventarëve nga krahasimi i gjendjes kontabël me gjendjen fizike si dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve.

-Amortizimi i llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale është kryer në grup aktivesh sipas llojit dhe jo për çdo aktiv në mënyrë të veçantë.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Durrës, të merren masa nga Sektori i Pronës Publike dhe Nëpunësi Zbatues nga ku të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Brenda vitit ushtrimor

4. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i kontratave për investime publike për vitet 2018 dhe 2019 kemi përpunuar të dhënat, gjendjen e detyrimeve të prapambetura nga shpenzimet kapitale. Nga përpunimi i të dhënave kemi realizuar testimin e saktësisë së llogarisë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” si llogari debitorë dhe testimin e saktësisë së llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” si llogari kreditorë të regjistrimit në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, vendimeve gjyqësore për shkak të mungesës së fondeve.

Detyrimet nga kontratat për investime publike gjatë viteve 2018-2019:

Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, që kanë lidhje me **9 kontrata**, ku vlera e mbetur e palikujduara e tyre prej 66,589,586 lekë nuk është evidentuar në kontabilitet. Vlerë kjo e cila duhej të përfshihej në pasqyrat financiare të vitit 2020 në llogarinë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me kundërparti llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, duke qenë se janë kontrata të cilat ju ka kaluar afati 2 vjeçar, si dhe likuidimi i tyre duhej të parashikohej edhe në PBA 2018-2021.

Pra shihet qartë se detyrimi i prapambetur lindur nga shpenzimet kapitale në vitet 2018 dhe 2019, nuk është pasqyruar. Kjo ka sjellë mos pasqyrimin e saktë të gjendjes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën **66,589,586 lekë**, për vitin financiar të mbyllur 2020. (Aneksi nr.3.1)

4.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundërparti së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për shumën **66,589,586 lekë** për kontratat e lidhura gjatë viteve 2018-2019, ku rezultojnë të pa likuiduara. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave për investime publike dhe për mbikëqyrje punimesh për vitin 2020 rezultoi se disa fatura nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2020 si një detyrim për tu paguar:

1.Për kontratën e lidhur me OE A..., në datën 12.10.2020 për investimin “Loti nr.2, Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa pallat në kuadër të procesit të rindërtimit”, me vlerë kontrate me TVSh 134,561,020 lekë, me financim nga Buxheti i Shtetit, me urdhër shpenzimin nr.153 datë 10.02.2021 është likuiduar vlera e faturës prej **30,344,910 lekë**, (fatura nr.54 datë 30.12.2020), kjo faturë duhej të paraqitej në pasqyrat financiare të vitit 2020, në llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, si një detyrim për t’u paguar pasi i përket vitit ushtrimor 2020.

2. Për kontratën e lidhur me OE T..., në datën 22.10.2020 për mbikëqyrjen e punimeve “Loti nr.2, Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa pallat në kuadër të procesit të rindërtimit”, me vlerë kontrate me TVSh 1,379,350 lekë, me financim nga Buxheti i Shtetit, me urdhër shpenzimet nr.414 datë 11.03.2021 dhe nr.416 datë 11.03.2021 janë likuiduar vlerat e faturave prej **717,262 lekë** dhe **303,457 lekë**, (fatura nr.45 datë 21.12.2020 dhe fatura nr.03 datë 30.12.2020), fatura të cilat duhet të paraqiteshin në pasqyrat financiare të vitit 2020, në llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, si një detyrim për t’u paguar pasi i përket vitit ushtrimor 2020.

Detyrimet në total prej **31,365,629 lekë**, duhet të ishin pasqyruar në analitikët e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, pasi janë detyrime të konstatuara gjatë vitit ushtrimor 2020 referuar dhe datave të faturave përkatëse. Mos kryerja e veprimeve kontabël për këto detyrime e si rrjedhojë mospërfshirja e vlerës që lindin nga këto detyrime ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale në fund të vitit ushtrimor 2020, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real për detyrimet që ka Bashkia ndaj të tretëve. (Aneksi nr.3.2)

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Durrës, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”, duke e nënvlerësuar me 31,365,269 lekë, si rrjedhojë e mos regjistrimit të faturave të cilat i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fiskal 2020.

Nga ana e Bashkisë Durrës, pas saktësisimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

6. Gjetje nga auditimi: Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Durrës, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 178,266,156 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se përbëhet nga 186 objekte nga të cilat për **125 objekte** në vlerën prej **84,474,102 lekë**, janë fonde që gjenden të ngurtësuar deri në vitin 2018, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhbllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Drejtoria e Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Pra llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 84,474,102 lekë për vitin 2020.

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Durrës, Sektori i Financës dhe Sektori i mbikëqyrjes së kontratave, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë nr.466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duke rakorduar sektorët çdo muaj mbi gjendjen e llogarisë nr.466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tanimë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi Tematik.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT